



**PROCESI I VAKSINIMIT
NDAJ GRIPIT SEZONAL
2024-2025**

**DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE**

PROGRAMI KOMBËTAR I VAKSINIMIT

JAVA 44, 2024

Qeveria Shqipëtare ka marrë masat për të siguruar si çdo vit, vaksinën ndaj gripit sezonal për grupet prioritare përpara fillimit të sezonit të gripit sezonal.

Në javën e fundit të muajit shtator 2024 në “Programin e Vaksinimit”, ISHP, kanë ardhur 280 000 doza vaksinë gripi, 4 valente dhe fushata e vaksinimit ndaj gripit sezonal 2024-2025 filloi në datën 4 Tetor 2024 në të gjithë vendin. Të gjitha grupet prioritare të përcaktuara mund të vaksinohen ndaj gripit në të gjithë vendin dhe janë garancia më e mirë për të ulur shtrimet në spitale, format e rënda të sëmundjeve respiratore dhe vdekjet si pasojë e komplikacioneve nga viruset respiratore duke u mbështetur në rekomandimet e NITAG.

Gjatë sezonit 2024 -2025 janë duke u aplikuar vaksinat ndaj gripit sezonal 4 valente të inaktivizuara për të gjitha grupmoshat mbi 6 muajsh si më poshtë:

1. Vaksinë e gripit (virion i copezuar, e inaktivizuar) -Influenza vaccine (split virion, inactivated), GC FLU 4 valente me 10 doza - Quadrivalent Multi Inj në flakonë shumë dozësh 5 ml e prodhuar nga GC Biopharma në Republikën e Koresë (Korea e Jugut) dhe e parakualifikuar për përdorim nga Organizata Botërore e Shëndetësisë në dozën 0,5 ml me përdorim intramuskular.
2. Vaksine e gripit (virion i copezuar, e inaktivizuar) -Influenza vaccine (split virion, inactivated), GC FLU 4 valente me 1 doze - Single Inj në flakon 1 dozë 0,5 ml e prodhuar nga GC Biopharma në Republikën e Koresë (Korea e Jugut) dhe e parakualifikuar për përdorim nga Organizata Botërore e Shëndetësisë në dozën 0,5 ml me përdorim intramuskular.


Për një ecure sa më të mirë të këtij procesi "Programi Kombëtar i Vaksinimit", ISHP, organizoi takim online datë 3/10/2024 me të gjithë epidemiologët dhe vaksinatorët e vendit.

Personat në risk për t'u vaksinuar ndaj gripit gjatë këtij sezoni janë si më poshtë:

- Punonjës shëndetësor (mjek, infermier, staf mbështetës)
- Të sëmurë me sëmundje kardiovaskulare, diabet, sëmundje pulmonare dhe sëmundje të tjera kronike të mëlçisë ose veshkave, të sëmurët me tumor/kancer
- Persona obezë
- Persona me imunitet të kompromentuar
- Gra shtatzëna
- Personat mbi 65 vjeç
- Mësues/ edukatorë
- Policë dhe forcat e rendit
- Fëmijë 6 muaj-12 vjeç

Të dhënat e vaksinave të aplikuar hidhen në kohe reale ne SIV, Sistemi Elektronik i Vaksinimit, dhe Kartela e Vaksinimit mund të gjenerohet në eAlbania. Ndërkohë çdo person mund të rezervojë ditën dhe orën e saktë të takimit në QSH përkatëse nëpërmjet aplikacionit në eAlbania, Rezervim për vaksinimin, për të aplikuar vaksinën ndaj gripit sezonal i cili ofrohet falas.

Aplikimi dhe hedhja në SIV e vaksinave të gripit ka filluar në **04.10.2024** dhe ka patur një ecuri të mirë dhe janë aplikuar në total 151 569 doza, **54 % e dozave të shpërndara.**



Grafiku 1 Ecuria e procesit të vaksinimit ndaj gripit sezonal, java 44, 2024

Vaksinimi ndaj Gripit në nivel qarku në përqindje, java 44





Figura 1: Përqindja e përdorimit të vaksinës e shprehur ne hartë

Personat në risk për t'u vaksinuar ndaj gripit janë personat mbi 65 vjeç dhe vihet re që administrimi i vaksinës në këtë grup- moshë është më e lartë në krahasim me grup-moshat më të reja. (Grafiku 2)



Grafiku 2: Numri i dozave te aplikuara sipas grup-moshave, java 44, 2024

INSTITUTI SHENDETIT PUBLIK

DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISE DHE KONTORLLIT TE SEMUNDJEVE INFEKTIVE